



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të të nenit 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 6.2 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr. 03/L-226 dhe nenit 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, miratoi:

## **VENDIM**

### **PËR DHËNIEN E PALUJTSHMËRISË NË PRONËSI TË KOMUNËS PËR SHFRTËZIM AFATGJATË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**

#### **Neni 1**

Qeverisë të Republikës së Kosovës - Ministrisë së Punëve të Brendshme në Prishtinë, për ndërtimin e Objektivit të përbashkët për QKRC dhe QKRA me destinim ushtrimi i veprimtarisë në ofrimin e shërbimeve për nevoja të qytetarëve të Komunës së Podujevës, i jepet në shfrytëzim afatgjatë paluajtshmëria në pronësi të Komunës së Podujevës evidentuar sipas Certifikatave nr.71712062-00244-10 ngastra kadastrale nr.244-10 klasa 1 vendi i quajtur “Qytet” në sipërfaqe prej 0.02.05 ha dhe nr.717112062-00244-8 ngastra kadastrale nr. 244-8 klasa 1 vendi i quajtur “Qytet” në sipërfaqe prej 0.04.95 ha, zona kadastrale Podujevë, gjithsej 0.07.00 ha.

#### **Neni 2**

Kohëzgjatja dhe shfrytëzimi afatgjatë të paluajtshmërive përkatëse caktohen konform nenit 5.3 dhe 5.6 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

#### **Neni 3**

Shfrytëzuesi i paluajtshmërisë nuk mund të bëjë tjetërsimin e të njejtës dhe nuk mund ta shfrytëzojë për qëllime të tjera përveç destinimit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të paluajtshmërisë përkatëse më afërsisht do të përcaktohen me kontratë të veçantë.

## **Neni 5**

Kushtet tekniko-urbanistike për ndërtimin e Objektivit të cekur i cakton Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

## **Neni 6**

Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë e bën bartjen në Elaboratin kadastral të paluajtshmërisë së përshkruar sipas nenit 1 të këtij Vendimi, në shfrytëzim afatgjatë në emër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

## **Neni 7**

Vendimi hyn në fuqi pas miratimit, përkatësisht 8 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

**Nr. 01/40-02**  
**Podujevë,**  
**29 shkurt 2012**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Hazir Raçi**